



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# PLANI I VEPRIMIT

## Federata e Basketbollit të Kosovës

# 2021

**Përgatiti:**

**Elvira DUSHKU**

**Sekretare e Përgjithshme**

**Federata e Basketbollit të Kosovës**

**24.12.2020, Prishtinë**

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Përmbajtja

- Ballina
- Përmbajtja
- Për Federatën e Basketbollit të Kosovës
- Vizioni, Misioni dhe Vlerat e Federatës së Basketbollit të Kosovës
- Hyrje
- Grupet e Interesit
- Analiza SWOT
- Objektivat Strategjike
- Garat e FBK-së
- Klubet
- Aktivitetet e Përfaqësuesve të Kosovës
- Aktivitetet për trajnerët
- Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues
- Projektet Zhvillimore
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore
- Udhëtimet zyrtare
- Eventet tjera organizative
- Rekomandime
- Përmbledhje
- Njësia matëse (Annex 1)

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Për Federatën e Basketbollit të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është federata e dytë më e madhe në vendin tonë (pas Federatës së Futbollit të Kosovës).

FBK në gjirin e saj i ka rreth 114 klube, prej tyre rreth 74 sosh janë të kategorive të reja (U12, U14, U16, U18) në të dyja konkurrencat.

FBK në edicionin 2019/20 i ka numëruar 16 liga: *Superliga e Kosovës; Superliga e Femrave; Liga e Parë e Femrave; Liga e Parë e Meshkujve; Liga e Dytë e Meshkujve; Superliga U18; Liga Unike U18; Liga U16 Lindje; Liga U16 Perëndim; Superliga U16; Liga U16 Vajzat; Liga U14 Lindje; Liga U14 Perëndim; Liga U14 Vajzat; Liga U12 Lindje; Liga U12 Perëndim;*

Përveç ligave, FBK organizon edhe Kupën e Kosovës në të dyja konkurrencat dhe për të gjitha grupmoshat, si dhe Superkupën e Kosovës, në të dyja konkurrencat.

Në FBK janë të regjistruar:

- 1500 basketbollistë dhe basketbolliste;
- Prej tyre rreth 1000 të kategorive prej U12 deri në U18 në të dyja konkurrencat;

FBK gjatë një edicioni në nivel të garave vendore organizon:

- 400 ndeshje në kategorinë e seniorëve në të dyja konkurrencat;
- 750 ndeshje në kategoritë e reja në të dyja konkurrencat;

Përveç garave vendore që FBK i organizon, prej vitit 2015 kur edhe jemi anëtarësuar në FIBA, ne rregullisht marrim pjesë me Përfaqësuesen A të Kosovës dhe me Përfaqësuese të Reja në garat zyrtare të FIBA-s.

Federata e Basketbollit të Kosovës në dy vitet e fundit i ka organizuar dy FIBA Kampionate Evropiane, ku në vitin 2018 ka qenë organizatore e FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, me ç'rast Kosova pati triumfuar dhe kështu është promovuar në Divizionin B, ku edhe aktualisht merr pjesë, derisa në vitin 2019, FBK ka qenë organizatore e FIBA U20 Kampionatit Evropian, Divizioni B – Femrat dhe vitin e ardhshëm do të organizojë FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C në Prishtinë.

Përveç me Përfaqësuese, Kosova në arenën ndërkombëtare paraqitet edhe në nivel të dy klubeve, së fundi në të dyja konkurrencat, derisa primatin e mbanë Sigal Prishtina, skuadër kjo që deri më tani e ka arritur suksesin më të madh në FIBA Europe Cup, duke zënë vend në mesin e 16 ekipeve më të mira të kësaj gare prestigjioze.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës është pjesë e programeve të FIBA-s, siç janë TIME OUT Program, FECC, FIBA Europe Girls Program dhe FIBA Youth Development Program. Këto dy të fundit fokusin e kanë masivizimin e basketbollit ndër djem dhe vajza të reja.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## VIZIONI

Për përparimin e basketbollit në Kosovë për tu bërë histori suksesi në të gjitha nivelet.

### *Çfarë do të thotë kjo:*

- Të arrijmë të regjistrojmë 4,000 anëtarë deri më 31 Dhjetor 2025;
- Të kualifikohemi me një ekip nacional të Kosovës (Meshkuj/Femra) në një garë të nivelit të lartë deri më 31 Dhjetor 2025;
- Ta bëjmë basketbollin sportin tonë më të dashur (nëpërmjet hulumtimeve);
- Të bëhemi financiarisht të qëndrueshëm. Deri më 31 Dhjetor 2025 të eliminojmë të gjitha borxhet.

## MISIONI

Për të qeverisur, zhvilluar dhe rritur sportin e basketbollit në Kosovë.

## VLERAT

**Ne synojmë të arrijmë misionin tonë nëpërmjet një grupi të qartë vlerash që na udhëheqin në të gjitha vendimet e marra në FBK:**

**Vizioni** - Jemi vizionarë, kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe gjithmonë mendojmë se si ta bëjmë basketbollin më tërheqës në vendin tonë për të gjithë anëtarët dhe grupet e interesit;

**Pasioni** - Jemi të apasionuar pas basketbollit, komunitetit tonë dhe vendit tonë;

**Fitorja** - Jemi fitues dhe mundohemi të promovojmë dhe krijojmë mentalitet të fituesit tek lojtarët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë;

**Respekti** - Respektojmë shumëllojshmërinë dhe lirinë e mendimit dhe gjithmonë udhëhiqemi nga parimet e gjithë përfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë;

**Zelli** - Punojmë me zell dhe angazhohemi për ta përmbushur misionin dhe vizionin dhe vizionit tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e zellshme.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Hyrje

Një Plan i Veprimit të Federatës së Basketbollit të Kosovës për vitin 2021 është vlerësuar si i domosdoshëm në mënyrë që të bëhet edhe renditja e aktiviteteve të FBK-së, por edhe të parashtrihen objektivat strategjike, si dhe njësia matëse e këtyre objektiveve, gjithnjë duke u bazuar në Planin Strategjik të FBK-së 2021-2025.

Federata e Basketbollit të Kosovës në kalendarin e saj të vitit 2021 numëron një numër të madh të aktiviteteve qofshin ato vendore dhe ndërkombëtare, të cilat sigurisht se e kanë një kosto të madhe, për të cilën mban përgjegjësi Bordi i FBK-së në krye me Kryetarin e FBK-së dhe Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së, konform Statutit të FBK-së, derisa për implementimin e këtyre aktiviteteve do të përkujdeset Zyra Ekzekutive e FBK-së në bashkëpunim me Grupet e Interesit të FBK-së.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Grupet e Interesit

### STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E BASKETBOLLIT 2021-2025

#### CILAT JANË GRUPET E INTERESIT TË FBK-së?

Basketbollistët/et	Klubet
Shkollat e basketbollit	Kuvendi
Bordi	Komiteti Ekzekutiv
Stafi	Vullnetarët
Drejtoritë Komunale të Sportit	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
Ministria e Arsimit	Komiteti Olimpik i Kosovës
FIBA/FIBA Europe	Federatat Nacionale
Sponsorët	Donatorët
Trajnerët	Referët
Delegatët	Mediat
Mjekët sportiv	Prindërit
Shikuesit	Federatat



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Analiza SWOT

<p><b>Pikët e forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Basketbolli, sport i popullarizuar;</li><li>- Vullnet i madh nga FBK për të implementuar Planin e Veprimit;</li><li>- Hartimi i Planit Strategjik të FBK-së;</li><li>- Rritja e interesimit për basketbollin;</li><li>- Imazh pozitiv i FBK-së në FIBA;</li><li>- Imazhi pozitiv i FBK-së tek Ambasadat dhe organizatat e huaja në Kosovë;</li><li>- Përfaqësueset e Kosovës në gara ndërkombëtare;</li><li>- Zyra Ekzekutive në rritje profesionale;</li></ul>	<p><b>Pikët e dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Mungesa e infrastrukturës sportive;</li><li>- Mungesa e trajnerëve 100% të fokusuar në basketboll;</li><li>- Mungesa e trajnerëve të Mini-Basketbollit;</li><li>- Mungesa e ekspertëve vendor;</li><li>- Deficiti financiar;</li><li>- Mungesa e një instituti të basketbollit;</li></ul>
<p><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përkrahja nga institucionet;</li><li>- Rrjetet sociale, interneti dhe uebsite;</li><li>- Projektet zhvillimore;</li><li>- Bashkëpunim i mirë i FBK-së me Federatat tjera Nacionale;</li><li>- Krijimi i një insituti të basketbollit;</li></ul>	<p><b>Kërcënimet</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Rritja e konkurrencës në raport me sportet tjera;</li><li>- Mos-sigurimi i sponsorëve konform planit;</li><li>- Mos-sigurimi i përkrahjes financiare nga qeveria sipas planit;</li><li>- Covid19;</li></ul>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Objektivat Strategjike

### *Objektivat Strategjike të Federatës së Basketbollit të Kosovës për vitin 2021 janë:*

- Rritja e numrit të anëtarëve të regjistruar në FBK;
- Regjistrimi dhe licencimi i të gjitha shkollave të basketbollit që veprojnë në Kosovë;
- Fillimi i implementimit të projektit të Mini-Basketbollit;
- Fuqizimi i projektit të FIBA Europe Youth Development Fund;
- Fillimi i Edukimit Bazik për trajnerët në Kosovë;
- Fillimi i Edukimit për trajnerët e Mini-Basketbollit;
- Rritja e numrit të vajzave që e praktikojnë basketbollin nëpërmjet kampanjës “Her World, Her Rules”;
- Rritja e numrit të refereve femra;
- Rritja e numrit të administratoreve femra;
- Masivizimi i basketbollit 3x3 në shkolla dhe Universitete;
- Funksionimi i Qendrës Nacionale të Basketbollit;
- Fuqizimi i klubeve tona;
- Promovimi i Kosova U16 Meshkujt në Divizionin B;
- Identifikimi i lojtarëve vendor nga jashtë vendi – potencial për Përfaqësuesen A;
- Rritja e imazhit të Përfaqësueses A - Femrat;
- Rritja e të hyrave në FBK;
- Zvogëlimi i deficit financiar;
- Krijimi i një identiteti korporativ të ri të FBK-së;
- Investimi në burimet njerëzore të FBK-së;
- Fuqizimi i projektit të Ligës UNIKE;
- Organizimi i turneve të përbashkët në konkurrencën e femrave, Kosovë-Shqipëri;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i brendit të Federatës së Basketbollit të Kosovës;
- Organizimi i projekteve të përbashkët me Ambasadat e huaja e organizata të tjera në Kosovë për promovimin e basketbollit ndër vajza dhe komunitete të tjera që jetojnë në Kosovë.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Garat e FBK-së

- Organizimi i garave në kategorinë seniore në të dyja konkurrencat;
- Organizimi i garave në kategoritë e reja në të dyja konkurrencat;
- Organizimi i Final 8 Kupës së Kosovës;
- Organizimi i Superkupës së Kosovës;
- Bashkërendimi i garave me Ligën UNIKE;
- Organizimi i turneve në konkurrencën e femrave, Kosovë – Shqipëri;
- Krijimi i Ligës së Shkollave (pilot projekt).



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Organizimi i garave në kuadër të FBK-së dhe në bashkëpunim me FSHB</i>	<i>Nëpërmjet ligave të ndara në kategori dhe në dy konkurrenca, dhe turneve me FSHB</i>	<i>Komesari i Garave</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>	<i>FBK FSHB MKRS FIBA</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Ngritja e cilësisë dhe masivizimi i basketbollit të Kosovë në trojet shqiptare</i>	<i>Klubet Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet</i>	<i>Përfshirja e basketbollit nëpër të gjitha regionet e Kosovës dhe më gjerë</i>	<i>Në bazë të informatorëve dhe raporteve të Komesarit të Garave</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Klubet

- Rregullorja e re për Licencim të Klubeve;
- Organizimi i seminareve për klubet (antidoping, menaxhim, qeverisje të mira, planifikim strategjik etj);
- Garat ndërkombëtare?;
- Shpërblimet;
- Donacionet (veshmbathje sportive, topa, etj);



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Fuqizimi i klubeve tona</i>	<i>Grupi i Punës i emëruar nga Bordi i FBK-së  Seminare, Punëtori, Klinika.</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar – Maj</i>	<i>FIBA FBK MKRS Partnerët / Sponsorët</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Ngritja profesionale e klubeve tona</i>	<i>Klubet dhe anëtarët e saj</i>	<i>Të kemi klube sa më të strukturuar</i>	<i>Në bazë të raporteve</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës

- Pjesëmarrja e Kosova A në parakualifikimet evropiane për FIBA Kupën e Botës 2023;
- Pjesëmarrja e Kosova A – Femrat për herë të parë në gara zyrtare, përkatësisht në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Reja në FIBA Kampionate Evropiane: U16, U18 dhe U20 në konkurrencën e meshkujve dhe U18 në konkurrencën e femrave;
- Pjesëmarrja e Përfaqësueses 3x3 në gara zyrtare të FIBA-s;
- Seminaret për antidoping për basketbollistët/basketbollistet dhe shtabin teknik të Përfaqësueseve;
- Seminare për ndihmëstrajnerët për aplikimin e sistemit Synergy Scouting.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi</b> <b>(Çfarë)</b>	<b>Detyra</b> <b>(Si)</b>	<b>Përgjegjësi</b> <b>(Kush)</b>	<b>Afatet</b> <b>(Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Pjesëmarrja e Përfaqësueseve të Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s</i>	<i>Nëpërmjet FIBA Kampionateve Evropiane dhe parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023</i>	<i>Drejtori i Përfaqësueseve të Kosovës</i>	<i>Shkurt Qershor – Gusht Nëntor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Paraqitja sa më e mirë për në gara ndërkombëtare</i>	<i>Trajnerët Basketbollistët Basketbollistët</i>	<i>Ngritja e cilësisë tek basketbollistët / et e reja të Kosovës, por edhe tek trajnerët</i>	<i>Në bazë të raporteve të Drejtorit të Përfaqësueseve dhe trajnerëve  Rishikimi i punës nga në shtator së bashku me Këshillin Profesional</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Aktivitetet për trajnerët

- Organizimi i edukimit bazik për trajnerët në bashkëpunim me FIBA-n;
- Organizimi i edukimit bazik për trajnerët e Mini-Basketbollit;
- Organizimi i seminareve/klinikave parasezonale;
- Pjesëmarrja në FIBA Konventën e Mini-Basketbollit;
- Pjesëmarrja në FIBA U14 Get Together;
- Pjesëmarrja në programin për trajnerë të FIBA-s, FECC;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Zhvillimi dhe edukimi i trajnerëve kosovarë</i>  <i>Rritja e numrit të trajnerëve të kualifikuar</i>	<i>Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit</i>  <i>6 Kurset të Nivelit 1 në kuadër të programit të edukimit të trajnerëve të WABC.</i>  <i>Kurse të Mini-Basketbollit nëpërmjet Solidaritetit Olimpik</i>	<i>Drejtori Teknik i FBK-së</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK</i> <i>MKRS</i> <i>FIBA</i> <i>Sponsorët</i> <i>Partnerët</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Edukimi profesional i trajnerëve</i>	<i>Trajnerët</i> <i>Drejtori Teknik i FBK-së</i>	<i>Të kemi trajnerë të edukuar</i>	<i>Në bazë të raporteve të Drejtorit Teknik</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues

- Organizimi i FIBA SCOD Klinika parasezonale;
- FIBA PRNC Klinika;
- FIBA SCOD Kampi;
- Play Off Klinika;
- Klinika FIBA Referee Instructor;
- Pjesëmarrja e gjyqtarëve kosovarë në ndarjen e drejtësisë në FIBA Kampionate Evropiane të gjeneratave të reja;
- Kampi Veror për gjyqtarë;
- SCOD seminari për gjyqtarë dhe vëzhgues;
- Mbajtja e Klinikës për Statistika;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Zhvillimi i gjyqtarëve kosovarë</i>	<i>Nëpërmjet klinikave, seminareve brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndarje të drejtësisë në gara zyrtare të FIBA-s</i>	<i>Koordinatori Nacional i FBK-së</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të rritet për cdo vit numri i gjyqtarëve kosovarë me thirrje të FIBA-s dhe “profesionalizmi” i gjyqtarëve dhe vëzhguesve të rinj</i>	<i>Gjyqtarët Vëzhguesit Koordinatori Nacional i FBK-së</i>	<i>Të kemi gjyqtarë dhe vëzhgues cilësorë</i>	<i>Në bazë të raporteve të Koordinatorit Nacional si dhe evaluimit personal të gjyqtarëve</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Projektet zhvillimore

- Qendra Nacionale e Basketbollit;
- Minibasketbolli;
- Basketbollit 3x3;
- FIBA Europe YDF Program;
- FIBA Europe Girls Program;
- Kampi Nacional i FBK-së;
- Kampi në Postojna të Sllovenisë.



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Masovizimi Identifikimi Mbetja në basketboll Zhvillimi Organizimi</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në turne, kampe, klinika, si dhe organizimeve në vendin tonë të aktiviteteve me karakter ndërkombëtar</i>	<i>Drejtori Teknik në FBK</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Komunat</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave që e praktikojnë basketbollin</i>	<i>Koordinatorët / et Trajnerët / et Basketbollistët</i>	<i>Fëmijët të mbeten në basketboll</i>	<i>Në bazë të raporteve të Drejtorit Teknik</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>
<i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave të moshës prej 5 deri në 10 vjeç që e praktikojnë basketbollin</i>	<i>Basketbollistet</i>				

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Edukimi dhe shkollimi i stafit të zyrës ekzekutive në programet e FIBA-s, KOK-ut, UEFA-s etj;
- Aktivitete për ndërtim të kapacitetit të brendshëm në *FBK*;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<i>Veprimi (Çfarë)</i>	<i>Detyra (Si)</i>	<i>Përgjegjësi (Kush)</i>	<i>Afate (Kur)</i>	<i>Burime</i>
<i>Investimi në kuadro dhe kthimi prapa i këtij investimi</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në Punëtori, Klinika dhe Seminare</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA KOK</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të rritet cilësia tek kuadrot</i>	<i>Stafi i zyrës ekzekutive</i>	<i>Të arrihet profesionalizmi</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Udhëtimet zyrtare

- Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Europe;
- Pjesëmarrja në Takimin Vjetor të Sekretarëve të Përgjithshëm të FIBA Evropës;
- Pjesëmarrja në Lojërat Olimpike në Tokio;
- Pjesëmarrja në shortin e Përfaqësueseve të Reja;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<i>Veprimi (Çfarë)</i>	<i>Detyra (Si)</i>	<i>Përgjegjësi (Kush)</i>	<i>Afatet (Kur)</i>	<i>Burime</i>
<i>Udhëtime me karakter të “netëorking”</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Mars Prill Maj Nëntor Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Prezantim sa më i mirë i FBK-së</i>	<i>Zyrtarët e FBK-së</i>	<i>Bashkëpunimi me Federatat tjera Nacionale  Zhvillimi i projekteve të përbashkëta</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Eventet tjera organizative

- “FIBA Bubble” në kuadër të Dritares së Tretë të parakualifikimeve evropiane për FIBA Kupën e Botës 2024;
- Lansimi i Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025;
- FIBA U16 Kampionati Evropian, Divizioni C, Prishtinë;
- Organizimi i Kuvendit të Punës të FBK-së;
- Organizimi i eventit të shpalljes së Më të Mirëve nga ana e FBK-së për vitin 2021;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët/sponsorët e FBK-së;



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Plani i Veprimit

<i>Veprimi (Çfarë)</i>	<i>Detyra (Si)</i>	<i>Përgjegjësi (Kush)</i>	<i>Afate (Kur)</i>	<i>Burime</i>
<i>Pjesëmarrja e vazhdueshme e FBK-së në organizime të eventeve të FIBA-s</i>	<i>Nëpërmjet përgatitjes së punës profesionale</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Grupet të tjera të interesit</i>

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të servojmë evente të organizimit në nivel të lartë</i>	<i>Stafi organizativ</i>	<i>Të sigurohen të hyra financiare nëpërmjet organizimit të këtyre eventeve</i>	<i>Në bazë të raporteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Rekomandimet

Është e rëndësishë së veçantë që Bordi i FBK-së, Komiteti Ekzekutiv dhe Zyra Ekzekutive ta marrin seriozisht qasjen ndaj implementimit të këtij plani, sepse vetëm në këtë mënyrë të gjitha ato që janë shkruar në këtë plan mund të realizohen dhe në fund të vitit do të mund të bëjmë evaluimin e vitit të parë të implementimit të Planit Strategjik të FBK-së.

Federata e Basketbollit të Kosovës si institucion serioz dhe përgjegjësi kryesor për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, do të duhej të jetë si rol model në të ardhmen, jo vetëm për klubet dhe gjithë anëtarët e saj, por edhe për të gjitha Federatat Sportive në vendin tonë.

Është e rëndësishë së veçantë që klubet e basketbollit dhe shkollat, apo shoqatat anëtare të saj të marrin shembull nga FBK, dhe në këtë mënyrë të vazhdojnë edhe ato me hartimin dhe implementimin e Planeve të Veprimit.

## Përmbledhje

Ky plan i veprimit është bazuar në Planin Strategjik të FBK-së 2021-2025. Plani përshkruan aktivitetet e përfshira në përmbushjen e objektivave specifike brenda një afati kohor të caktuar.

Federata e Basketbollit të Kosovës është e gatshme për një vit të suksesshëm të basketbollit në Kosovë, por për të realizuar një gjë të tillë ne kemi nevojë për përkrahjen e të gjitha Grupeve të Interesit të FBK-së, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, sepse vetëm së bashku ne mund ta zhvillojmë sportin tonë të dashur.

Ne besojmë fuqishëm se basketbolli është një platformë dhe nxitës për ndryshim. Çdo gjë që ne e bëjmë në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka ndikim në mijëra njerëz, si dhe ka ndikim në zhvillimin e vendit tonë. Është përgjegjësia jonë për të vazhduar punën për rritjen e ndikimit të sportit tonë.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

